



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА
PROGRAMI PËR MBËSHËTETJE PARLAMENTARE
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME

Dokument i shkurtë për politika publike nr. 57/2020

Cilësia e debatit në Kuvend:


Debat mbikëqyrës

për rastin e bankës

Eurostandard

Autori: Pero Jovanovski

Dhjetor 2020



Ky publikim është përpiluar në kuadër të Programit për Mbështetje Parlamentare (PSP), i cili mbështetet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) përmes Ambasadës Zvicerane në Republikën e Maqedonisë së Veriut. PSP implementohet nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup (IDSCS) dhe Qendra për Menaxhim me Ndryshime (QMN). Përmbajtja e botimit në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e SDC-së.

1. Hyrje

Kontrolli dhe mbikëqyrja politike mbi Qeverinë dhe mbi bartësit të tjerë të funksioneve publike është një nga kompetencat e përcaktuara me kushtetutë të Kuvendit. Një nga mekanizmat për ushtrimin e kësaj kompetence janë debatet mbikëqyrëse përmes të cilave kontrollohet puna e Qeverisë, përkatësisht zbatimi i ligjeve të miratuara, si dhe efekti i funksionarëve qeveritarë dhe nëpunësve në ekzekutimin e mandateve ligjore.¹ Përmes këtyre diskutimeve, deputetët marrin informacione dhe mendime ekspertësh për punën e organeve të pushtetit ekzekutivit dhe administratës shtetërore. Edhe pse përmes këtij mjeti Kuvendi mund të mbledhë informacione të rëndësishme në lidhje me punën e pushtetit ekzekutivit, ai praktikohet shumë rrallë.

Më 13 nëntor 2020, në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut, u organizua debat mbikëqyrës në lidhje me përcaktimin e arsyeve dhe zbatimin e ligjeve në procedurën për falimentimin e Eurostandard Bankës, si dhe ekzekutimin e ligjeve nga institucionet kompetente. Instituti për Demokraci, përmes Indeksit të Cilësisë së Debatit², monitoroi cilësinë e debatit në këtë seancë mbikëqyrëse dhe dha vlerësim për mënyrën dhe nivelin e paraqitjes së pozicioneve, si dhe sjelljen debatuuese të vetë pjesëmarrësve. Kjo analizë i referohet rezultateve të fituara nga ky monitorim, së pari përqendrohet në mënyrën e rregullimit të debateve mbikëqyrëse në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, që më pas në mënyrë më të gjerë të vlerësojë cilësinë e diskutimit në debatin mbikëqyrës, përkatësisht qëndrimin e pjesëmarrësve në debat, si dhe në cilin drejtim po lëvizte debati.

¹ NDI. „Procesi i debateve publike: Udhëzues për deputetë dhe shërbimin e Kuvendit.” (2011). Në dispozicion në: https://www.ndi.org/sites/default/files/Service_and_Accountability-MAK.pdf

² AICD e adaptuar, bazuar në instrumentin për vlerësimin e cilësinë e përgjithshme të debatit parlamentar, të zhvilluar nga Stenbergen; Steenbergen, Marco R., et al. "Measuring political deliberation: A discourse quality index." Comparative European Politics 1.1 (2003).

2. Rregullimi i debatit mbikëqyrës në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Debatin mbikëqyrës e organizon dhe realizon trupi punues amë i Kuvendit, dhe në të mund të marrin pjesë përfaqësues të autorizuar të Qeverisë, organeve shtetërore ose persona të cilët mund të japin informacione të rëndësishme për çështjen që është temë e diskutimit. Personat e ftuar, janë të ftuar në mënyrë të rregullt nga Kuvendi, përkatësisht nga Kryetari i trupit punues amë dhe kanë detyrimin të marrin pjesë në debatin mbikëqyrës.³

Në mënyrë që të organizohet debati mbikëqyrës, iniciativë ngrihet nga një anëtar i trupit punues amë ose debati mbikëqyrës mund të mbahet edhe nëse 15 deputetë në formë të shkruar e kërkojnë këtë

gjë përmes Kryetarit të Kuvendit deri te kryetari i trupit punues, atëherë kryetari i trupit punues është i detyruar të thërrasë menjëherë mirëmbajtjen e debatit. Në debatin mbikëqyrës, personave të thirrur u jepet së pari fjalë për të dhënë mendimin e tyre ose prezantimin mbi temën për të cilën është thirrur dhe më pas deputetët u bëjnë pyetje përfaqësuesve të autorizuar, por vetëm pyetjet që janë temë e diskutimit ndërsa ata janë të detyruar tu përgjigjen pyetjeve të shtruara nga deputetët. Në fund të debatit mbikëqyrës, trupi punues paraqet raport mbi debatin mbikëqyrës të mbajtur, dhe deklaratat përkatëse thelbësore, më pas trupi punues ka mundësi të propozojë konkluzione të caktuara dhe t'ia paraqesë ato Qeverisë.

³ Ligji për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. Në dispozicion në: <https://www.sobranie.mk/content/Zakon%20za%20Sobranie/ZAKON%20ZA%20SOBRANIETO%20NA%20RM.pdf>

3. Debat mbikëqyrës për rastin e Bankës Eurostandard

3.1. Falimentimi i Bankës Eurostandard

Në gusht të vitit 2020, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut morri vendim⁴ me të cilën revokohet licenca e punës së Bankës Eurostandard SHA Shkup dhe bankës iu dha administrues falimentimi, me çka fillon procedurat e falimentimit. Arsyet për këtë vendim janë mos përmbushja e kushteve të punës, siç thuhet në shpjegimin e "Bankës Popullore".. në lidhje me mbylljen e bankës Guvernatori i BP të Republikës së Maqedonisë së Veriut deklaroi se revokimit të lejes së punës i parapriu shterimi i të gjitha mundësive dhe masave për të mos falimentuar banka, por masat nuk kanë dhënë rezultat.⁵

Me mbylljen e Bankës Eurostandard, klientët e bankës, si fizikë ashtu edhe persona juridikë, mbetën

pa llogaritë e tyre të transaksionit dhe depozitat e kursimeve. Nga ana tjetër, ngelën pa paguar edhe kreditë e huave të personave fizikë dhe personave juridikë. Ky vendim hasi në komente negative nga klientët e bankës. Qytetarët e dëmtuar u gjendën në situatë të pa lakmueshme dhe kërkuan sqarimin e çështjes. Përveç klientëve të bankës, aksionari më i madh Trifun Kostoski është prekur gjithashtu nga mbyllja e bankës, i cili deklaroi se mbyllja e bankës është "e padrejtë dhe e papranueshme."⁶ Shumë pyetje dhe dilema u ngritën rreth mbylljes së bankës, veçanërisht nëse mund të ishin parandaluar procedurat e falimentimit, nëse BPRMV-së kishte përdorur të gjithë mekanizmat, me atë që ky rast ishte subjekt i akuzave politike ditore midis qeverisë dhe opozitës.

⁴ Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut "Informacion për personat fizikë dhe juridikë të cilët ishin klientë të Eurostandard Bank "SHA Shkup" (2020). Në dispozicion në: <https://www.nbrm.mk/ns-newsarticle-soopstenie-nb-fod-12082020-2.nspix>

⁵ Dojçe Vele. „ Në gjurmët e parave - cila është e vërteta rreth rënies së Bankës Eurostandard "(2020). Në dispozicion në: <https://www.dw.com/но-трагата-на-парите-која-е-вистината-за-пропаѓањето-на-евростандард-банка/a-55597101>

⁶ Mitrovska, S. MIA. „I will seek justice in the case of Eurostandard Bank outside of the country". (2020). Available at: <https://mia.mk/kostovski-pravdata-za-stecha-ot-na-eurostandard-banka-e-a-baram-nadvor-od-zem-ata/>

3.2. Debat mbikëqyrës me temë : "Përcaktimi i arsyeve dhe zbatimi i ligjeve në procedurën që rezultoi me falimentim të Bankës Eurostandard SHA Shkup"

Më 13 nëntor 2020, Komisioni për Financa dhe Buxhet në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut, organizoi një seancë mbikëqyrëse me temë "Përcaktimi i arsyeve dhe zbatimi i ligjeve në procedurën për falimentim të Bankës Eurostandard AD Shkup". Qëllimi i këtij debati mbikëqyrës ishte të fitohen informacione konkrete dhe relevante dhe mendime profesionale në lidhje me zbatimin e politikave dhe zbatimin e ligjeve në këtë rast, të përcaktohen arsyet e falimentimit të bankës dhe të miratohen konkluzione përkatëse. Për më tepër, ky debat mbikëqyrës është i rëndësishëm në drejtim të ruajtjes së stabilitetit monetar dhe financiar të vendit dhe mbrojtjes së stabilitetit, sigurisë dhe funksionalitetit të sistemit bankar, si dhe në drejtim të parandalimit të ngjarjeve të tilla ose të ngjashme në të ardhmen.

Përveç anëtarëve të Komisionit për Financa dhe Buxhet dhe deputetë të tjerë, u ftuan edhe pjesëmarrës të jashtëm në rolin e dëshmitarëve, të cilët dhanë deklarata gojore dhe iu përgjigjën pyetjeve të shtruar nga deputetët. Kështu, në atë rol ishin: Guvernatorja e Bankës Popullore, Anita

Angellovska-Bezhoska; prokurori publik Ljubomir Joveski; Ministri i Financave, Fatmir Besimi; drejtori i Drejtorisë së Policisë Financiare, Arafat Muaremi; drejtori i Drejtorisë për Kundërzbulim Financiar Bllazho Trendafilov; Akademik Abdylmenaf Bexheti; profesori Nikolla Popovski, anëtar i MBDP; profesor Gligor Bishev anëtar i Asociacionit të Bankave të Maqedonisë; Trifun Kostovski, aksionar më i madh në Eurostandard Bank dhe Olivera Klinçarova, anëtare e bordit iniciues të Shoqatës së Personave Fizik dhe Juridik të dëmtuar "Drejtësi për depozituesit". Nga të gjithë të ftuarit, vetëm Administratori i emëruar për falimentim i Bankës Eurostandard SHA Shkup, Dushko Todevski, nuk mori pjesë në debatin mbikëqyrës, për të cilën mungesë nuk dha shpjegim përkatës.

Pas debatit mbikëqyrës, Komisioni për Financa dhe Buxhet do të caktojë vazhdim të seancës mbikëqyrëse në të cilën do të analizohen të gjitha deklaratat e dhëna nga dëshmitarët e thirrur dhe përgjigjet me shkrim nga dëshmitarët, si dhe materialet shtesë të paraqitura nga institucionet përkatëse dhe informacione. Nëse komisioni vendos që nevojiten informacione shtesë, do të ftojë dëshmitarë të tjerë. Në vazhdim të seancës mbikëqyrëse, do të nxirren konkluzione dhe do të vendoset për miratimin e tyre të mëtejshëm.

⁷ Kuvendi i R. M. së Veriut "Debat mbikëqyrës për Bankën Eurostandard" (2020). Në dispozicion në: https://www.sobranie.mk/2020-2024-aktivnosti-ns_article-nadzorna-rasprava-na-komisijata-za-finansiranje-i-budzet-za-eurostandard-banka.nspix

3.3. Analizë mbi cilësinë e debatit

Dëshmitarët e ftuar fillimisht dëshmuan në lidhje me çështjen, dhe pastaj deputetët u parashtruan pyetje. Gjithsej 56 pjesëmarrës morën pjesë në diskutim dhe numri i përfaqësuesve të jashtëm që morën pjesë në diskutim ishte i barabartë me numrin e deputetëve, përkatësisht 26 përfaqësues të jashtëm në rolin e dëshmitarëve dhe 26 deputetë. Gjatë gjithë debatit mbikëqyrës, nuk kishte asnjë kufizim në fjalimin e pjesëmarrësve ose ndërprerje në fjalimet e tyre. Lidhur me gjininë e pjesëmarrësve në diskutim, 18% ishin gra, ndërsa 82% ishin burra.


Shkalla e argumentimit të diskutimit

—

Lidhur me shkallën e argumentimit të folësve në debatin mbikëqyrës, nga diskutimet e analizuara të deputetëve dhe përfaqësuesve të jashtëm, mbizotëruan argumente përgjithësisht të dobëta në fjalimet e tyre, në rreth 82% të fjalimeve të tyre. Një pjesë e konsiderueshme e pyetjeve të bëra nga deputetët ishin në formën e tezave dhe akuzave kundër pjesëmarrësve të jashtëm, të cilave dëshmitarët e ftuar u dhanë përgjigje kryesisht të

arsyetuara dobët, pa shpjegime të hollësishme. Kjo do të thotë që folësit nuk ofruan shpjegim të pozicioneve dhe tezave të tyre në nivel që është i mjaftueshëm për t'u konsideruar argument i plotë, ndërsa në 16% të fjalimeve nuk kishte argumente, përkatësisht arsyetimi i folësve nuk ishte mbështetur sa duhet me fakte që të konsiderohet se kanë diskutuar në mënyrë të argumentuar. Argumentim përkatës vërejmë vetëm në 2% të fjalimeve.

Grafiku nr 1. Diskutim i argumentuar dobët



Përfshirja e arsytimit


Folësit në fjalimin e tyre, përkatësisht në përmbajtjen e arsytimeve që u prezantuan në debatin mbikëqyrës në përqindjen më të lartë, përkatësisht 57% e folësve përfaqësuan interesat e një grupi të cilit nuk i përkasin, më saktë atyre që preken drejtpërdrejt nga mbyllja e bankës, klientët e bankës, personat fizik dhe personat juridikë, kursimtarët, të punësuarit, etj.

Për dobi neutrale ose neutral regjistruam 16% të fjalimeve, për grupin në të cilin ata vetë bëjnë

pjesë ose përfaqësojnë interesat e tyre regjistrojmë 15%, përkatësisht në fjalimet e aksionarit më të madh të bankës dhe një deputeti i cili është personalisht i prekur nga mbyllja e Bankës Eurostandard, për shkak se partia e tij është si person juridik klient i së njëjtës bankë, ndërsa përqindja më e vogël përkatësisht në 13% të fjalimeve vërejmë referencë për të mirën e përbashkët.

Grafiku nr 2. Në diskutim, interesat e personave më të prekur janë më të përfaqësuar (klientët e bankës, persona fizikë dhe juridikë, depozitues, punonjës, etj.)

Përfshirja e arsytimit




Përgjegjësi

Lidhur me atë se si deputetët iu përgjigjën argumenteve të drejtuara nga folës të tjerë, rezultoi se në 55% të diskutimeve asnjë argument dhe pyetje nuk janë adresuar nga bashkëbisedues tjetër. Kjo situatë është kryesisht për shkak të faktit se në debatin mbikëqyrës shumica e fjalimeve të analizuar janë pyetje të parashtruara nga deputetë përkatësisht dy deri në tre fjalime të njëpasnjëshme

me parashtrimin e pyetjeve adresuar përfaqësuesve të jashtëm. Në 21% të diskutimeve folësit adresuan argumentet e pjesëmarrësve të tjerë në mënyrë të përshtatshme, nga ana tjetër e ngjashme me këtë, në 20% të fjalimeve kishte injorim të pjesshëm, shtrembërim dhe adresim të argumenteve, ndërsa vetëm në 4% të rasteve argumentet nuk u injoruan, por të njëjtat u shtrembëruan.

Grafiku nr 3. Folësit adresojnë në mënyrë përkatëse argumentet e të tjerëve në 21% të diskutimit




Fuqia e argumentit më të mirë

Në 71% të diskutimeve, nuk u vërejt asnjë referencë për cilësinë e argumenteve të folësve të tjerë, sepse ata individualisht, në fusha të caktuara u parashtronin pyetje dëshmitarëve që ishin të ftuar, në lidhje me fushën e tyre për të cilën ishin ftuar dhe nuk i lidhën me argumente të tjera në diskutimin e tyre. Numër i vogël i tyre iu referuan argumenteve

dhe pozicioneve të tjera, kështu që vetëm në 27% të diskutimeve të folësve nuk kishte asnjë ndryshim në qëndrimet e tyre. Përfundimisht, në vetëm 2% të diskutimit vërehet se folësit nuk i ndryshuan qëndrimet e tyre sepse ata i përkasin të njëjtës parti politike, kështu që ata pranuan argumentet e folësve të tjerë, përkatësisht bashkë partiakëve të tyre.

Grafiku nr 4. Për pjesën më të madhe të diskutimit, folësit nuk iu referuan argumentit të tjerëve




Qëndrimi ndaj pjesëmarrësve të jashtëm

Elementi i pjesëmarrësve të jashtëm është thelbësor në debatet mbikëqyrëse, gjegjësisht prania e tyre është e rëndësishme për mbajtjen e debatit mbikëqyrës për të shprehur qëndrimet e tyre. Kështu edhe ky debat mbikëqyrës u zhvillua në atmosferë korrekte, pa ndërprerje, pa kufizime dhe në të morën pjesë të gjithë përfaqësuesit e jashtëm të ftuar, përveç një.

Kur bëhet fjalë për raportin e deputetëve ndaj pjesëmarrësve të jashtëm, ky raport pasqyron kulturën parlamentare të deputetëve. Kështu, në 50% të fjalimeve të tyre, deputetët nuk iu referuan pjesëmarrësve të jashtëm të pranishëm në debatin

mbikëqyrë dhe në fjalimet e tyre nuk ndërtuan ndonjë qëndrim ndaj tyre. Në 41% të fjalimeve, deputetët kishin shprehur respekt të pjesshëm për pjesëmarrësit e jashtëm ose të paktën një qëndrim të konstruktuar ndaj tyre. Vetëm në 7% të diskutimit, deputetët shprehën shprehimisht respekt në fjalimin e tyre para pjesëmarrësve të jashtëm, gjë që tregon kulturë relativisht të ulët të debatit. Ndërsa në 2% të diskutimit vërehet mosrespektim i pjesshëm i pjesëmarrësve të jashtëm, ku deputetët gjatë parashtrimit të pyetjeve në fjalimin e tyre shprehën mosrespektim të pjesshëm ndaj pjesëmarrësve të jashtëm.

Grafiku nr 5. Deputetë nuk krijuan qëndrim ndaj personalitetit të pjesëmarrësve të jashtëm në diskutim



Raporti ndaj argumenteve të pjesëmarrësve të jashtëm

Diskutimi në debatin mbikëqyrës zakonisht argumentohet dobët, si nga deputetët ashtu edhe nga pjesëmarrësit e jashtëm. Lidhur me qëndrimin e deputetëve ndaj argumenteve të shprehura, në përqindjen më të madhe, përkatësisht në 89% të diskutimit, deputetët nuk iu referuan aspak argumenteve të pjesëmarrësve të jashtëm. Në

5% të fjalimeve, deputetët shprehën mosrespektim të pjesshëm, dhe një përqindje pak më e ulët është regjistruar në respektim të pjesshëm 4%. Në mënyrë të ngjashme, respekt ndaj argumenteve të pjesëmarrësve të jashtëm vërehet në vetëm 2% të diskutimit.

Grafiku nr 6. Në pjesën më të madhe të diskutimit, deputetët nuk ndërtuan qëndrim ndaj argumenteve të pjesëmarrësve të jashtëm në diskutim

Raporti ndaj argumenteve të pjesëmarrësve të jashtëm (%)



4. Përfundim

Në përgjithësi, ky debat mbikëqyrës me temë "Përcaktimi i arsyeve dhe zbatimi i ligjeve në procedurën e falimentimit të Bankës Eurostandard SHA Shkup" u zhvillua në atmosferë të korrekte, pa ndërprerje, pa kufizime dhe në të morën pjesë të gjithë përfaqësuesit e jashtëm të ftuar, përveç një.

Nga ana tjetër, cilësia e debatit të pjesëmarrësve mund të vlerësohet si e dobët. Një pjesë e konsiderueshme e pyetjeve të bëra nga deputetët ishin në formën e tezave dhe akuzave kundër pjesëmarrësve të jashtëm, të cilave dëshmitarët e ftuar u dhanë përgjigje kryesisht të arsyetuara dobët, pa shpjegime të hollësishme. **Pjesëmarrësit në diskutim kryesisht i mbështetën dobët prezantimet e tyre me argumente.**

Shumica e pjesëmarrësve me fjalimet e tyre përfaqësuan interesat e njerëzve të prekur nga rasti në fjalë, përkatësisht interesat e klientëve të

bankës - persona fizikë dhe persona juridikë, të punësuarit dhe të tjerë. Në shumicën e diskutimeve në debatin mbikëqyrës, asnjë argument dhe pyetje nuk u adresua nga bashkëbisedues tjetër, ndërsa në raste të tjera raporti ndaj tyre ishte pothuajse i ndarë, përkatësisht 21% ishin adresuar në mënyrë përkatëse, dhe nga ana tjetër te 20% u vërejt injorim i pjesshëm, shtrembërim dhe adresim të argumenteve. Në mbi dy të tretat e diskutimeve të pjesëmarrësve, nuk u vërejt asnjë referencë për cilësinë e argumenteve të folësve të tjerë, ndërsa në 27% të diskutimeve pjesëmarrësit nuk ndryshuan pikëpamjet e tyre dhe nuk i pranuan argumentet e pjesëmarrësve të tjerë. Kur bëhet fjalë për raportin e deputetëve ndaj personalitetit të pjesëmarrësve të jashtëm, mund të konkludohet se gjysma nuk iu referuan pjesëmarrësve të jashtëm, ndërsa 48% shprehën respekt të pjesshëm ose të plotë për personalitetin e tyre.

5. Rekomandime

Me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe peshën e debatit mbikëqyrës si një nga mjetet për mbikëqyrje të Kuvendit mbi pushtetin ekzekutiv, është e nevojshme të bëhen ndryshime në legjislacion në lidhje me disa segmente. Një nga ndryshimet duhet të jetë në drejtim të **sigurimit të praktikimit më të rregullt të këtij mekanizmi mbikëqyrës, si dhe miratim i një plani për debate mbikëqyrje në nivel vjetor.**

Për më tepër, nevojiten edhe **ndryshime me të cilat do të sigurohej prania e detyrueshme e dëshmitarëve të ftuar në debat**, dhe parashikimin e sanksioneve përkatëse nëse mungesa e tyre nuk është arsyetuar në mënyrë përkatëse. Në këtë mënyrë, do të garantohej dëshmia e të gjitha palëve

relevante në rastet konkrete, gjë që do të siguronte miratimin e konkluzioneve më të informuara dhe veprim nga Kuvendi.

Gjithashtu është e nevojshme të rritet cilësia e debatit dhe niveli i argumentimit të fjalimeve të deputetëve. Kjo mund të arrihet duke rritur informimin dhe njohuritë mbi temat që janë lëndë e diskutimit, si dhe përmirësimin e aftësive debatuese dhe oratorike të deputetëve. **Instituti Parlamentar (IP), i cili funksionon në kuadër të Kuvendit, ofron shërbime që mund të adresojnë këto nevoja të deputetëve dhe së këndejmi nevojitet përdorim më i madh dhe më efektiv i shërbimeve të IP-së nga deputetët.**



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА
PROGRAMI PËR MBËSHITJE PARLAMENTARE
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME

Dokument i shkurtë për politika publike nr. 57/2020

**Cilësia e debatit në Kuvend:
Debat mbikëqyrës
për rastin e bankës
Eurostandard**

Autori: Pero Jovanovski

Dhjetor 2020